



## KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT SH. A. PEJË



Zyret Qendrore

Rr. Lekë Dukagjini nr 156

Telefoni:

[www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com)

30000 Pejë

039 / 432 355

Bordi i Drejtoreve i KRU "HIDRODRINI" SH.A., Pejë i emëruar sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës -Vendim Nr. 11/118 dt. 11.01.2023, duke u bazuar në kompetencat sipas dispozitave ligjore të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike , nr.03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-042, nr.04/L-111 dhe numër 05/L-009, nenin 21 që përcakton kompetencat ekskluzive të Bordi të Drejtoreve dhe bazuar në nenin 14 të Statutit të Kompanisë Rajonale të Ujësllësit "HIDRODRINI" SH.A- Pejë, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrje Publike pika 15, Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e mbajtur me datën 31.07.2024 në mënyrë unanime merre këtë:

### V E N D I M

1. Shkarkohet nga detyra e Kryeshefit Ekzekutiv të KRU Hidrodrini, Dri Cena me efekt të menjëhershëm;
2. Tërhiqet autorizimi nr. 687/23 i dt.27.06.2023 bankar i Dri Cena në të gjitha bankat komerciale dhe i ndalen gjitha të drejtat e gëzuara si kryeshef ekzekutiv.

### Arsyetim

Pas vlerësimit negativ të performancës që BD i bën KE për punën provuese 6 mujore në dhjetor të vitit 2024, atij i zgjatet kontrata e punës me qëllim që të reflektojë dhe të përmirësojë sjelljen e tij udhëheqëse. Bordi këtë vendim e arsyetoi se KE ka mungesë përvojë në udhëheqje të ndërmarrjeve publike. Megjithatë, përgjatë 6 muajve të vitit 2024, ai nuk ka treguar vullnet, përpjekje e as shenja për përmirësim. Pozita financiare e ndërmarrjes është pavolitshme për shkak të rritjes së shpenzimeve dhe dështimit në rritjen e inkasimit sipas planifikimit në plan të biznesit. Performanca e dobët qëndron kryesisht për shkak të mos përmbushjes së dy objektivave kryesore të specifikuar në PB, siç janë: dështimi në redukimin e humbjeve të ujit, dështimi në zvogëlimin e llogarive të arketueshme dhe dështimi në rritjen e të hyrave. Përkundrazi, caqet e synuara kanë marrë kahje të kundërt.

Bordi ka humbur besueshmërinë për shkak të parregullsive të vazhdueshme në kontabilitet, në raportimin e të dhënave zyrtare dhe në analiza të ndryshme, që konstatohen edhe me raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe me raportin e auditimit nga ana e ARRU. Raportimet e pasakta kanë vënë bordin në lajthitje për të marrë vendime që kërcënojnë seriozisht qëndrueshmërinë financiare në vitin fiskal 2024.

Udhëzimet dhe rekomandimet e bordit janë përbuzur dhe injoruar në vazhdimësi gjatë periudhës 14 mujore. Pjesa dërmuese nga 175 rekomandime të dhëna nuk janë zbatuar, të cilat kanë çuar në dështim të menaxhimit të rrezikut që ndërlidhet me indikatorin etik, financiar, indikatorin njeri dhe atë strategjik sipas Kodit të Etikës të Qeverisjes Korporative për NP. Ka zgjatur kontratën e dr. Teknik në mënyrë arbitrare pa përfillur këshillën e Bordit dhe të akteve të brendshme ligjore për shpalljen e konkursit të jashtëm. Gjithashtu, anulon dhe rishpall serish konkurs të brendshëm për pozitën e drejtorit komercial në kundërshtim me udhëzimin e ri administrativ nr.01/2024. Ka dështuar në hartimin e dokumenteve strategjike udhëheqëse, si: plani i veprimit, plani për menaxhimin e humbjeve të ujit, plani për menaxhimin e thatësirave, plani për menaxhimin e ujëmatësve, plani për menaxhimin e rrezikut, etj. Shkarkon nga detyra U.D. ITUN dhe lë impiantin pa udhëheqës duke rrezikuar asetin më me vlerë të ndërmarrjes, një investim 23 milionësh. Gjithashtu, bordi ka gjetur se ai kishte shpërblyer veten dhe ZKF kundërligjshëm me pagesa shtesë për punë jashtë orarit, për çka bordi detyrohet të kërkoj kthimin e mjeteve financiare. Më tej, ka angazhuar avokat privat për përfaqësime ligjore për shkak se ishte rekrutuar një zyrtar ligjor i papërvojë, inkompetent dhe pa kritere ligjore, duke rënduar kështu buxhetin e ndërmarrjes në mënyrë të dyfishtë.

Ka hyrë në marrëveshje kontraktuale me operatorë privat pa procedurë prokurimi dhe kështu kishte bërë vepër të kundërligjshme. Bordi ka gjetur se përmes vendimeve të tij arbitrare janë avansuar persona të preferuar në pozita që nuk ekzistojnë në aktet e brendshme juridike dhe ka paguar ata pa bazë ligjore për disa muaj. Kërcënon dhe hakmerret dhe shkarkon zyrtarët e “padëgjueshëm” arbitrarisht dhe bashkëpunon ngushtë me zyrtarë të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit mbi NP, BD unanimisht vendosi të shqiptoj edhe vërejtën e dytë me shkrim (përveç 2 vërejtjeve me gojë që i janë dhënë) dhe rrjedhimisht ta shkarkojë atë nga detyra.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tije, nga data 31.07.2024

**Këshilla juridike:** Pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj të drejtën e ankesës në gjykatën themelore në Pejë, në afat prej tete (8) ditësh

Jusuf Nikçi  
  
Kryesues i Bordit të Drejtoreve



Vendimi i dërgohet:

- 1xBordit të drejtorëve,
- 1x ME-NJPMNP-Prishtinë,
- 1x Arkivit të NP,
- 1x palës.